

## **Komentet e Kryetarit në detyrë të Prezencës së OSBE-së, Robert Wilton, pas takimit me Avokatin e Popullit**

30 korrik 2013

**Kryetari në detyrë Robert Wilton:** Gjatë javëve të para në Shqipëri, kam bërë takime me politikanë shqiptarë të partive të ndryshme politike. Është hera e parë që flas para medias dhe më duket me vend që ta bëj këtë pikërisht pas takimit me Avokatin e Popullit.

Vizioni im për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri është që ajo të punojë në partneritet dhe në mbështetje të institucioneve shqiptare dhe popullit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në realizimin e aspiratave të tyre për një shoqëri demokratike.

Roli, forca dhe efikasiteti i Avokatit të Popullit si një institucion qendror dhe i pavarur është thelbësor për statusin e Shqipërisë, si një demokraci moderne dhe funksionale. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka qenë aktive në një sërë fushash, që lidhen me të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, dhe me lirinë e medias në partneritet me institucionin e Avokatit të Popullit. Unë jam shumë krenar këtë punë, jam shumë krenar për bashkëpunimin tonë dhe shpresoj që të vazhdojmë po kështu edhe në të ardhmen.

**Pyetje nga Erion Skendaj (News 24):** Komplimente së pari për shqipen shumë të kuptueshme. Pyetja është: Kohët e fundit janë dy veprime që në Shqipëri, tek popullata kanë impakt. I pari është çështja e toponimeve me Greqinë dhe i dyti është një ligj, i cili ka të bëjë me një vendim qeverie, që më pas është mishëruar në ligj dhe që po nxjerr njerëzit nga shtëpitë e ish-pronarëve, pa i sistemuar më parë këto në banesa sociale. Janë shumë. Flitet për 3400 familje në të gjithë Shqipërinë, pra janë mbi 15 mijë persona, të cilët janë të pastrehë me këtë ligj. Një koment tuajin për këtë.

**Kryetari në detyrë Robert Wilton:** Sa i përket çështjes së toponimeve, kjo është një çështje që duhet adresuar nga qeveria e Shqipërisë dhe qeveria e Greqisë. Unë di që Avokati i Popullit ka folur tashmë publikisht në emër të të drejtave të qytetarëve shqiptarë dhe nuk kam asgjë për të shtuar nga ana e OSBE-së për këtë temë.

Sa i përket çështjes së pronave, çështja e të drejtave të pronësisë është themelore për stabilitetin e Shqipërisë si një demokraci. Është shumë e rëndësishme për shtetin e së drejtës, për pavarësinë ekonomike të njerëzve. Ajo është, gjithashtu, vendimtare për investimet e huaja. Prezenca e OSBE-së ka punuar në të kaluarën, duke u përpjekur që t'i ndihmojë institucionet shqiptare në fushën e të drejtave të pronësisë. Ne jemi të gatshëm që të vazhdojmë të punojmë në partneritet me Bashkimin Europian, të cilët kanë qenë donatorë shumë bujarë për këtë proces. Pra, ne jemi të gatshëm që të vazhdojmë të punojmë për këtë çështje, por gjithçka varet nga vullneti i institucioneve për ta marrë këtë çështje seriozisht, pasi është një çështje e komplikuar.

**Pyetje nga Erion Skendaj (News 24):** Sa u përket personave që mbeten të pastrehë?

**Kryetari në detyrë Robert Wilton:** Ne kemi pasur përfaqësime nga këto familje dhe kemi bërë diçka, duke u përpjekur për t'i dhënë një nxitje gjetjes së një zgjidhjeje. Kemi organizuar një takim për të adresuar këtë çështje. Kuptohet që kjo është një situatë aspak e këndshme

dhe e vetmja mënyrë për t'u adresuar është adresimi në një plan afatgjatë përmes një procesi serioz reformash dhe një qasjeje plot angazhim si nga institucionet, ashtu edhe nga njerëzit. Dhe kjo është në themel dhe tërësi një çështje e shtetit të së drejtës dhe e të drejtave të individëve. Gjithçka që mund të them është se ne inkurajojmë një qasje plot angazhim për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

**Pyetje nga Elona Gjylmi (Albanian Screen):** Z. Ambasador, ka kaluar më se një muaj që nga dita e zgjedhjeve në Shqipëri dhe duket se jemi akoma larg certifikimit të rezultatit. A është cenuar në këtë pikë standardi i zgjedhjeve, i cili u duk se u arrit deri diku me procesin e votimit dhe numërimit?

**Kryetari në detyrë Robert Wilton:** Unë po pres raportin përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it në Shqipëri. Ai ka për të qenë raporti më i plotë, më i hollësishëm dhe më i specializuar për këto zgjedhje dhe shpresoj që të merret seriozisht. Ashtu siç thatë edhe ju, procesi zgjedhor vazhdon. Ai po vazhdon në institucionet e duhura, institucionet shqiptare të pavarura zgjedhore, pikërisht ashtu siç duhet të ndodhë. Ajo çka unë do të kërkoja është që të gjithë aktorët në këtë proces të vazhdojnë t'i respektojnë këto institucione, të vazhdojnë të respektojnë ligjet dhe procedurat e këtyre institucioneve dhe, ajo çka është më themeloria, që të respektojnë votat e qytetarëve shqiptarë. Dhe unë shpresoj që të kemi një proces që mbyllet me stabilitet dhe rezultat të pranuar nga të gjitha palët.